



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.31, datë 20/09/2023

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT, PËR QËLLIME TË NDRYSHME, TË SUBJEKTIT “EHW” SH.P.K, ME VENDNDODHJE, AUTOSTRADA TIRANË-DURRËS KM 4.8, KASHAR, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të shoqërisë “EHW” sh.p.k, “Kërkesë për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit, për qëllime të ndryshme, me vendndodhje, Autostrada Tiranë-Durrës Km 4.8, Kashar, Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH)

-X=479144.7; Y=4579616.4; Z=60 m.m.n.d

Prurja e ujit të kërkuar: Q=2 l/sek

Thellësia e pus-shpimit: 30 m

Thellësia e vendosjes së pompës : 25m

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

-X=479044.8; Y=4579487.6; Z=61 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

